

PROCESVERBAL – Tipi i kontratës - Mall

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

OBJEKTI I PROCEDURËS: “Furnizim dhe vendosje elektropompa në stacionin e pompave Fushë-Milot”

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV):

- POMPA CENTRIFUGALE 42122430-3, INVERTER 31155000-7

FONDI LIMIT: 149,500,000 (Njeqind e dyzet e nente milion e peseqind mije) Lek pa TVSH

Vlera e fondit Limit ne monedhen nderkombetare Euro sipas kursit te Bankes se Shqiperise eshte 1,625,000 (Nje milion e gjashteqind e njezet e pese mije) Euro.

Kursi zyrtar i kembimit sipas Bankes te Shqiperise datë 10.09.2026 është 92.00 euro.

Argumentimi: Perlllogaritja e vleres se fondit limit eshte bere referuar Nenit 35 te ligjit nr.162/2020, si dhe nenit nr.13 dhe nenit nr.76 te VKM 285 date 19.05.2021, të ndyshuar.

Argumentimi në lidhje me Nenin 39, të Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” (i ndryshuar), për mos ndarjen në lote të procedurës së prokurimit:

***Sqarim:*Argumentimi për mosndarjen e procedurës në lote.**

Referuar Ligjit Nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, neni 2 ku prashikohet shprehimisht se: “Qëllimi i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Në kreun V, Neni 42, pikat 1 dhe 2 e Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti/enti kontraktor e ndan një kontratë në lote sa herë kjo është e mundur. Në çdo rast, duhet të përcaktohet qartë madhësia dhe objekti i këtyre loteve.
2. Autoriteti kontraktor, në procedurat e prokurimit mbi kufirin e lartë monetar, në rast se vendos të zhvillojë procedurën e prokurimit pa e ndarë në lote, duhet të parashikojë një përcaktim të arsyeve kryesore për këtë vendim, i cili bëhet pjesë e dosjes së tenderit. Ky detyrim nuk zbatohet në rastin e kontratave sektoriale.”

Në përputhje me nenin 42 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për rregullat e prokurimit publik”, autoriteti kontraktor ka detyrimin të vlerësojë mundësinë e ndarjes së kontratës në lote kur procedura është mbi kufirin e lartë monetar. Pas analizës së objektit të prokurimit “**Furnizim dhe vendosje elektropompa në stacionin e pompave Fushë-Milot**”, është konstatuar se ndarja në lote nuk është e përshtatshme për arsyet e mëposhtme:

Mosndarja e procedurës në lote justifikohet nga **natyra e unifikuar, teknike dhe funksionale e objektit të prokurimit**, i cili konsiston në furnizimin dhe vendosjen e elektropompave në stacionin e pompave Fushë-Milot, me qëllim garantimin e funksionimit të plotë dhe të sigurt të sistemit të pompimit.

Objekti i prokurimit përbën një **tërësi të vetme teknike dhe funksionale**, pasi furnizimi me elektropompa dhe vendosja/instalimi i tyre janë veprime të lidhura ngushtë dhe të ndërvarura. Ndarja e tyre në lote të veçanta do të krijonte nevojën për koordinimin e operatorëve ekonomikë të ndryshëm dhe mund të sillte vështirësi në përcaktimin e përgjegjësive për përputhshmërinë teknike të pajisjeve me instalimet ekzistuese, instalimin, testimin dhe vënien në funksion të tyre.

Gjithashtu, kërkesa për **përputhshmëri të plotë ndërmjet elektropompave dhe infrastrukturës ekzistuese të stacionit të pompave** e bën të nevojshme që furnizimi dhe vendosja të trajtohen në mënyrë të integruar. Një operator i vetëm përgjegjës për të gjithë procesin krijon një pikë të vetme përgjegjësie për cilësinë, performancën, instalimin, testimin dhe funksionalitetin e pajisjeve të furnizuara.

Ndarja në lote, në këtë rast, **nuk do të sillte përfitime të dukshme në aspektin teknik apo ekonomik**, ndërkohë që mund të shtonte nevojën për koordinim ndërmjet kontraktorëve të ndryshëm, të rriste riskun e mosrakordimit teknik dhe të vështirësonte identifikimin e përgjegjësive në rast të problematikave gjatë instalimit apo funksionimit të elektropompave.

Për më tepër, procedura ka për objekt realizimin e **një nevoje konkrete dhe të unifikuar të stacionit të pompave Fushë-Milot**, dhe jo prokurimin e një sërë nevojash të pavarura nga njëra-

tjetra. Për këtë arsye, ndarja e objektit në lote nuk konsiderohet e përshtatshme, pasi komponentët e tij janë të lidhur drejtpërdrejt me njëri-tjetrin dhe synojnë realizimin e një rezultati të vetëm: **furnizimin, instalimin dhe vënien në funksion të elektropompave në stacion.**

Në përfundim, duke marrë në konsideratë lidhjen e drejtpërdrejtë teknike dhe funksionale ndërmjet furnizimit dhe vendosjes së elektropompave, nevojën për garantimin e përputhshmërisë së plotë me sistemin ekzistues, si dhe shmangien e risqeve që mund të lindin nga bashkëveprimi i operatorëve të ndryshëm, vlerësohet se **objekti i prokurimit nuk është i përshtatshëm për t'u ndarë në lote dhe realizimi i tij si një kontratë e vetme është më i përshtatshëm për garantimin e rezultatit të kërkuar teknik dhe funksional.**

2. KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Ofertuesi duhet të paraqesë:

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas **Shtojcës 4**;
- b. Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas **Shtojcës 9**;

2. Ofertuesi duhet të paraqesë:

2.1 Kapacitetin profesional të operatorëve ekonomikë:

Sipas Shtojcës 9 (Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit).

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenit 40, pika 5, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik". Shtojcës 9

2.2 Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1 Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit.

Kërkesa e mësipërme konsiderohet e përmbushur nëse operatorët ekonomikë arrijnë vlerën e xhiros minimale, në të paktën një vit të periudhës së kërkuar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, të Ligjit nr.162/2020 "Për prokurimin publik", i ndryshuar, si dhe nenin 43, VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", i ndryshuar, si dhe nenin 13 të Ligjit nr.8438, datë 28.12.1998 "Për Tatimin Mbi të Ardhurat" i ndryshuar, ku përcaktohen kushtet dhe afatet e dorëzimit për deklaratat individuale vjetore të të ardhurave.

Percaktimi i vleres se kerkuar argumentohet si me poshte;

Pika 1 dhe pika 2/b, neni 43 e VKM-së Nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikon marzhin maksimal për vlerën e xhiros, që mund të kërkohet, përkatësisht; Pika 2/b: *vlerën e përllogaritur të kontratës ose lotit , në procedurat e prokurimit ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar;.. Duke qenë se kjo procedurë prokurimi është ndërmjet kufirit të lartë dhe të ulët monetar, AK duke u bazuar në eksperiencën e suksesshme të procedurave të zhvilluara me parë, rëndësisë së objektit të prokurimit, rëndësisë së Autoritetit Kontraktor, seriozitetit të marrëdhënieve kontraktuale me operatorë ekonomikë me aktivitet të vazhdueshëm në treg gjykon se është e përshtatshme vendosja e këtij marzhi të përcaktuar në Legjislacionin dhe Rregullat e Prokurimit Publik.*

2.2.2. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare 2023, 2024 dhe 2025 të konfirmuara nga administrata tatimore, ku të paktën në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit”. Kjo kërkesë konsiderohet e përmbushur nëse në dy bilance të njëpasnjëshme, nuk ka raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivitetit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, në Ligjin nr. 9920 datë 19.05.2008 “Për Procedurat Tatimore në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, dhe aktet nënligjore në zbatim të tij.

Kriteri ekonomik dhe financiar i shërben autoritetit kontraktor për të krijuar sigurinë se operatorët ekonomik kanë kapacitet financiar për zbatimin e marrëveshjes kuadër.

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1 Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për furnizimet e mëparshme të ngjashme, të kryera gjatë tre viteve të fundit nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës në një vlerë jo më të vogël se 39 % e fondit limit.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme:

- a) Për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin publik, operatori ekonomik duhet të paraqesë vërtetime të lëshuara nga një ent publik për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës, ose fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasi të mallrave të furnizuara.
- b) për përvojën e mëparshme të realizuar me sektorin privat, operatori ekonomik duhet të paraqesë fatura tatimore të shitjes të deklaruara në organet tatimore, të plotësuara sipas

kërkesave të legjislacionit në fuqi, ku shënohen datat, shumat dhe sasitë e mallrave të furnizuara.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77 të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 40, pika 4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën me sukses, prandaj është kërkuar që kontratat e mëparshme të ngjashme të jenë në vlerën jo më pak se 39 % të vlerës së fondit limit, që është brenda vlerës kufirit të përcaktuar në nenin e sipërcituar.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Vlera e parashikuar e kontratës, është mbi kufirin e lartë monetar. Vlera për furnizime të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvoja duke patur parasysh objektin dhe vlerën e fondit limit.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e kontratave të ngjashme që mund të kërkohet, autoritete/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të kontratave të ngjashme brenda këtij marzhi.

Përvoja e mëparshme është një element shumë i domosdosshëm që garanton autoritetin kontraktor se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së kontratave të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të jetë i pajisur dhe të paraqesë Çertifikatat **ose ekuivalentet e tyre**, në përputhje me objektin e prokurimit, të lëshuara nga një organ i vlerësimit të konformitetit, i akredituar nga organizmi kombëtar i akreditimit ose organizma ndërkombëtarë akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë, si më poshtë:

- Çertifikatë - SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001:2015 - “Sistemi i menaxhimit të cilësisë” ose ekuivalente
- Çertifikatë - SSH/UNI/DIN/EN ISO 14001:2015 – “Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit” ose ekuivalente, e barasvlefshme
- Çertifikatë - SSH/UNI/DIN/EN ISO 45001:2018 – “Sistemi i Menaxhimit të Shëndetit dhe Sigurisë në punë” ose ekuivalente

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a), nenin 79 të LPP, nenit 44 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar.

- Kërkesa për disponimin e certifikatës **SSH/UNI/DIN/EN ISO 9001:2015 ose ekuivalente**, për sistemin e menaxhimit të cilësisë, argumentohet nga natyra teknike e objektit të prokurimit, i cili përfshin furnizimin dhe vendosjen e elektropompave, si dhe kërkon garantimin e cilësisë dhe përputhshmërisë së pajisjeve të furnizuara me kërkesat teknike dhe kushtet e funksionimit të stacionit të pompave..
- Kërkesa për certifikatën **SSH/UNI/DIN/EN ISO 14001:2015 ose ekuivalente** argumentohet nga fakti se realizimi i objektit përfshin ndërhyrje dhe punime në një stacion ekzistues pompimi, gjatë të cilave mund të krijohen mbetje, materiale të dala nga çmontimi, ambalazhe të pajisjeve, vajra apo substanca të tjera të lidhura me pajisjet dhe procesin e instalimit.
Certifikimi sipas ISO 14001:2015 siguron që operatori ekonomik të ketë një sistem të strukturuar për identifikimin dhe administrimin e aspekteve mjedisore të veprimtarisë së tij, menaxhimin e mbetjeve dhe marrjen e masave për parandalimin ose minimizimin e ndikimeve negative në mjedis.
- Kërkesa për certifikatën **SSH/UNI/DIN/EN ISO 45001:2018 ose ekuivalente** argumentohet nga fakti se realizimi i objektit nuk kufizohet vetëm në furnizimin e pajisjeve, por përfshin edhe **vendosjen, instalimin, montimin, ndërhyrjet teknike dhe testimin e elektropompave në një stacion pompimi.**

Këto aktivitete mund të përfshijnë përdorimin e mjeteve dhe pajisjeve të punës, transportin dhe pozicionimin e pajisjeve me peshë të konsiderueshme, punime pranë instalimeve elektrike dhe mekanike, si dhe ndërhyrje në një infrastrukturë ekzistuese. Për këtë arsye, ekziston nevoja që operatori ekonomik të disponojë një sistem të strukturuar për identifikimin e rreziqeve në vendin e punës, vlerësimin dhe kontrollin e tyre, si dhe për garantimin e kushteve të përshtatshme të shëndetit dhe sigurisë për personelin e angazhuar.

2.3.3 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 *“Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”* të ndryshuar, në përputhje me zërat e punimeve që përfshihen në preventivin e punimeve,, e cila përfshin kategoritë e mëposhtme:

- **N.P - 7 D** Ujësjiellës, gazsjellës, vajsjiellës, vepra kullimi e vaditje.
- **N.S – 16 A** Ndërtimi i impianteve të ujërave të pijshme dhe pastrimit të tyre.

Për operatorët e huaj të bëhet njehsimi i licencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të licencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Shoqëritë e huaja duhet të bëjnë ekuivalentimin / njehsimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e

Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në, Nr.42, datë 16.01.2008). **Mosparaqitja në këtë formë është kusht s`kualifikues.**

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në Nenin 77, pika 1 të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar; Kreut V, Seksioni III, **Neni 39, pika 6/a**, të VKM Nr. 285, datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” i ndryshuar, si dhe mbështetur në Vendimin e Këshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16. 01. 2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”.

- Kërkesa për kategorinë **N.P-7 – Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje** justifikohet nga fakti se objekti i prokurimit përfshin **furnizimin dhe vendosjen e elektropompës në një stacion pompimi pjesë e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.** Preventivi përfshin, krahas furnizimit të elektropompës, edhe furnizimin dhe vendosjen e elementëve të sistemit të pompimit, si **tubacione, kolektorë, flanxha, saraçineska, kundravalvula, kompensatorë, rakorderi dhe elementë të tjerë lidhës.** Këto elemente janë pjesë funksionale e linjës së ujësjellësit dhe janë të nevojshme për lidhjen dhe vënien në funksion të elektropompës në stacionin e pompimit. Për këtë arsye, kërkesa për kategorinë **N.P-7** lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe objektin e kontratës dhe synon të garantojë kapacitetin profesional të nevojshëm për **furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve dhe elementëve përkatës në sistemin e pompimit të ujit.** Stacioni i pompimit ku do të realizohet furnizimi dhe vendosja e elektropompës është pjesë përbërëse e sistemit të furnizimit me ujë, ndërsa objekti i kontratës konsiston në furnizimin dhe vendosjen e elektropompës dhe elementeve mekanike/hidraulike përkatëse, të domosdoshme për funksionimin e sistemit të pompimit. Kërkesa është përcaktuar në funksion të objektit konkret të kontratës dhe në përputhje me parimin e proporcionalitetit, pasi lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe specifikën e furnizimit objekt prokurimi.
- Kërkesa për kategorinë **N.S-16 – Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimit të tij** justifikohet nga fakti se objekti i prokurimit përfshin **furnizimin dhe vendosjen e elektropompës në një stacion pompimi, i cili është pjesë e sistemit të furnizimit me ujë të pijshëm.** Furnizimi dhe vendosja e elektropompës, së bashku me elementët shoqërues të parashikuar në preventiv, si tubacionet, flanxhat, saraçineskat, kundravalvulat, kompensatorët dhe rakorderitë, janë të nevojshme për integrimin dhe funksionimin e saj në sistemin ekzistues të pompimit. Për këtë arsye, kërkesa për kategorinë **N.S-16** lidhet drejtpërdrejt me natyrën dhe objektin e kontratës dhe synon të garantojë që operatori ekonomik të ketë kapacitetin profesional të nevojshëm për **furnizimin dhe vendosjen e pajisjeve në impiante të ujit të pijshëm.**

2.3.4 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë **personelin kryesor, drejtues teknik** në licencën e shoqërisë, si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Mekanik
- b. 1 (një) Inxhinier Elektrik

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- 1. Kontratë pune të vlefshme,
- 2. Diplome,
- 3. Listepagesat e shoqërisë për 3 (tre) muaj nga data e zhvillimit të procedurës, ku duhet të figurojnë stafi i mësipërm

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikues ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 9, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gërmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 5, germa “b dhe c”.

Objekti i kontratës nuk kufizohet vetëm në furnizimin e pajisjeve, por përfshin edhe vendosjen, instalimin, montimin, lidhjet përkatëse, testimin dhe vënien në funksion të elektropompave në një stacion ekzistues pompimi. Për këtë arsye, realizimi i suksesshëm i kontratës kërkon angazhimin e specialistëve me formim të përshtatshëm për komponentët mekanikë, elektrikë dhe, në masën që parashikohet nga preventivi, ndërtimorë të punimeve.

a) Inxhinieri Mekanik

Kërkesa për një Inxhinier Mekanik është e lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, pasi elektropompat përbëjnë pajisje me karakter të theksuar mekanik dhe instalimi i tyre kërkon njohuri profesionale për montimin, pozicionimin, ankorimin, lidhjet mekanike, kontrollin e parametrave të punës, verifikimin e përputhshmërisë së pajisjeve me sistemin ekzistues dhe testimin e funksionimit.

Inxhinieri Mekanik do të jetë përgjegjës për mbikëqyrjen teknike të komponentëve mekanikë të punimeve dhe për garantimin që pajisjet e furnizuara dhe të instaluar të funksionojnë në përputhje me kërkesat teknike dhe kushtet e projektit.

Për këtë arsye, disponimi i një Inxhinieri Mekanik konsiderohet i nevojshëm dhe proporcional me natyrën e objektit të kontratës.

b) Inxhinieri Elektrik

Kërkesa për një Inxhinier Elektrik justifikohet nga fakti se elektropompat janë pajisje që kërkojnë furnizim, lidhje dhe kontroll elektrik, si dhe integrim me sistemin elektrik dhe të komandimit të stacionit të pompave.

Instalimi dhe vënia në funksion e elektropompave kërkon verifikimin e parametrave elektrikë, realizimin dhe kontrollin e lidhjeve elektrike, kontrollin e mbrojtjeve, komandimit dhe elementëve të tjerë elektrikë të parashikuar në projekt dhe në preventiv, si dhe kryerjen e testimeve përpara vënies në punë.

Për këtë arsye, Inxhinieri Elektrik është pjesë e domosdoshme e stafit teknik për garantimin e realizimit korrekt dhe të sigurt të komponentit elektrik të kontratës.

2.3.5. Operatori ekonomik, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë:

- a. 1 (një) Inxhinier Elektrik
- b. 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

1. Kontratë pune të vlefshme,
2. Diplome,
3. Listepagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit nga data e zhvillimit të procedurës, ku duhet të figurojnë stafi i mësipërm

Shënim: Në momentin e vlerësimit dhe shqyrtimit të kriterëve kualifikuese ky kriter do të konsiderohet i përmbushur me dorëzimin e vetdeklarimit përmbledhës sipas Shtojcës 9, bazuar në nenin 82 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik” si dhe në gjurmën dh) të pikës 2 të nenit 26 të Vendimit nr. 285 datë 19.05.2021 të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për tu kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor argumenton se kërkesa për stafin inxhinierik është vendosur sipas përcaktimeve të Ligjit Nr. 162, datë 23. 12. 2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar, Neni 77, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19. 05. 2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 40, pika 5, germa “b dhe c”.

a) Inxhinieri Elektrik. Kërkesa për një Inxhinier Elektrik si staf mbështetës lidhet me komponentin elektrik të elektropompave dhe nevojën për asistencë profesionale gjatë kontrollit, vendosjes dhe lidhjes së pajisjeve me instalimet ekzistuese.

Ky specialist do të shërbejë si staf mbështetës për verifikimin e parametrave elektrikë të pajisjeve, kontrollin e përshtatshmërisë së tyre me sistemin ekzistues, asistimin gjatë lidhjeve dhe kontrolleve elektrike, si dhe gjatë testeve që kryhen pas vendosjes së elektropompave.

Duke qenë se objekti përfshin pajisje elektromekanike, prania e ekspertizës elektrike synon të garantojë që vendosja e tyre të realizohet në përputhje me kërkesat teknike dhe kushtet e sigurisë.

b) Inxhinieri Hidroteknik. Kërkesa për një Inxhinier Hidroteknik lidhet drejtpërdrejt me funksionin e elektropompave dhe integrimin e tyre me sistemin hidraulik të stacionit të pompave.

Inxhinieri Hidroteknik nevojitet për verifikimin e parametrave hidraulikë të elektropompave, përshtatshmërinë e tyre me sistemin ekzistues, kontrollin e lidhjeve me rrjetin hidraulik, si dhe për asistencën teknike gjatë vendosjes dhe testimit të pajisjeve.

Ekspertiza hidroteknike është e nevojshme për të garantuar që pajisjet e furnizuara të jenë të përshtatshme për kushtet e punës së stacionit dhe që pas vendosjes të sigurohet funksionimi i tyre në përputhje me parametrat e kërkuar.

tyre të realizohet në përputhje me kërkesat teknike dhe kushtet e sigurisë.

2.3.6 Operatori ekonomik ofertues duhet të ketë të punësuar si staf teknik punonjës minimumi

- a. 2 (dy) Elektricist
- b. 2 (dy) Hidraulik
- c. 1 (një) Mekanik
- d. 1 (një) Saldator

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- 1. diploma/certifikata të arsimit profesional të lëshuara nga institucionet të akredituara sipas Ligjit Nr.15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në Republikën e Shqipërisë” ose ekuivalente,
- 2. kontratë pune të vlefshme, si dhe
- 3. listëpagesat e shoqërisë për 3 (tre) muajt e fundit, ku duhet të figurojë stafi i mësipërm

Argumentimi: vendosja e këtij kriteri bazohet në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar, dhe Neni 40, pika 5, germa “b dhe c”. të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për punonjesit e kualifikuar lidhet ngushtësisht me objektin e kontrates, relacionin teknik dhe zërat e punimeve, duke krijuar besueshmërinë se kane përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën.

a) Elektricistë

Kërkesa për dy elektrikistë lidhet me nevojën për realizimin e komponentit elektrik të vendosjes së elektropompave, përfshirë kryerjen e lidhjeve elektrike, kontrollin e kabllimeve, instalimin dhe lidhjen e pajisjeve me sistemin ekzistues, si dhe kryerjen e kontrolleve dhe testeve përkatëse.

Disponimi i dy elektrikistëve synon të mundësojë realizimin e punimeve elektrike në mënyrë të koordinuar dhe të sigurt, duke marrë në konsideratë karakterin teknik të pajisjeve dhe nevojën për ndërhyrje në një sistem ekzistues.

b) Hidraulikë

Kërkesa për dy hidraulikë lidhet me nevojën për realizimin e lidhjeve të elektropompave me sistemin hidraulik ekzistues të stacionit, përfshirë montimin, përshtatjen dhe kontrollin e lidhjeve të tubacioneve dhe elementëve përkatës.

Disponimi i dy hidraulikëve synon të sigurojë realizimin korrekt dhe të koordinuar të lidhjeve hidraulike dhe kontrollin e tyre pas vendosjes së elektropompave.

c) Mekanik

Kërkesa për një mekanik është e lidhur drejtpërdrejt me natyrën e elektropompave si pajisje elektromekanike. Mekaniku nevojitet për proceset e montimit dhe vendosjes së pajisjeve, kontrollin e komponentëve mekanikë dhe kryerjen e përshtatjeve të nevojshme gjatë instalimit.

Prania e këtij specialisti synon të garantojë që pajisjet të vendosen dhe montohen në mënyrë korrekte dhe në përputhje me kërkesat teknike.

d) Saldator

Kërkesa për një saldator është e justifikuar vetëm nëse gjatë vendosjes së elektropompave parashikohen punime konkrete saldimi, si ndërhyrje ose përshtatje në elementët metalikë, tubacionet apo konstruksionet mbështetëse të lidhura me instalimin.

Nëse preventivi dhe specifikimet teknike nuk parashikojnë punime saldimi, kjo kërkesë duhet të rishikohet, pasi nuk do të kishte lidhje të mjaftueshme me objektin konkret të kontratës.

2.3.7 Operatori ekonomik ofertues duhet të paraqesë në sistemin elektronik autorizim nga prodhuesi ose distributori i autorizuar nga prodhuesi për të gjitha mallrat dhe pajisjet e kërkuara.

Autorizimi duhet të përmbajë të dhëna të plota të prodhuesit si: telefon, e-mail, website, kjo e nevojshme për Autoritetin Kontraktor në rast verifikimi nga ana e tij.

Ne rast se do të paraqitet autorizim nga distributori i autorizuar nga prodhuesi OE duhet te paraqese dokumentacionin per te vertetuar lidhjen midis prodhuesit dhe distributorit zyrtar.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në ligjin nr.162/2020, neni 73 datë 23.12.2020”Për Prokurimin Publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik” si dhe me rekomandimin e APP, datë 20.03.2018, prot 3341/1.

AK gjykon se kriteri i përcaktuar mbi paraqitjen e Autorizimit të Prodhuesit ose nga Distributori i Autorizuar nga Prodhuesi është në përpjestim dhe i lidhur ngushtë me objektin e kontratës si dhe në përputhje me dispozitat ligjore të sipërcituara. Autoriteti kontraktor, duke qenë se është përfituesi direkt i kontratës objekt prokurimi, është në të drejtën e tij të garantohet se operatorët ekonomikë pjesëmarrës dëshmojnë origjinalitetin e mallrave të furnizuara, e rrjedhimisht mund t’u kërkojë ofertuesve të paraqesin dokumentacion lidhur me origjinën e mallrave të lëshuara direkt nga prodhuesi. Pra nëpërmjet vendosjes së kriterit të sipërpërmendur AK garantohet dhe fiton siguri se operatori ekonomik kontraktues do të furnizojë dhe do të përmbushë kontratën me sukses

2.3.8 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik katalog / skedën teknike te prodhuesit për mallrat dhe pajiset e kerkuara ku të tregohen dhe të markohen qartë karakteristikat e mallrave që do të ofrohen, në mënyrë që të krahasohet pajtueshmeria e tyre me specifikimet teknike.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 40, pika 6, gërma b) të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”. Vendosja e kriterit të sipërcituar është vënë në mbështetje të nenit 40 pika 6 gërma b) të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” I ndryshuar parashikohet shprehimisht.... Autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si: b) fotografitë apo katalogjet teknike

Paraqitja e katalogëve të prodhuesve është e nevojshme në funksion të verifikimit të përputhshmërisë së produkteve me specifikimet teknike të AK me qëllim realizimin e kontratës me sukses.

2.3.9 Operatori ekonomik duhet te paraqese në sistemin elektronik deklaraten e konformitetit CE per pompat e cila verteton perputhshmerine e tyre me direktivat europiane si me poshte:
- 2014/35/EU Direktiva e tensionit te ulet ose ekuivalent
- 2014/30 EU Direktiva e perputhshmerise elektromagnetike ose ekuivalent

Argumentimi: Kërkesa për paraqitjen e Deklaratës së Konformitetit CE/UE për elektropompat është përcaktuar në funksion të natyrës, parametrave dhe kushteve të funksionimit të pajisjeve

objekt furnizimi. Objekti i prokurimit parashikon furnizimin, instalimin dhe rakordimin e 8 (tetë) elektropompave centrifugale horizontale, shumëshkallëshe, të tipit high pressure, me prurje nominale 414 m³/h, lartësi manometrike 220 m, fuqi të absorbuar 298–305 kW dhe presion maksimal në dërgim deri në 63 bar, të pajisura me elektromotorë trefazorë me fuqi nominale 355 kW, tension 400 V dhe eficiencë IE4.

Për shkak të fuqisë së lartë të elektromotorëve, mënyrës së funksionimit të elektropompave dhe integritetit të tyre me 8 invertera/VSD me fuqi 400 kW, si dhe me sistemin e kontrollit dhe SCADA, është e nevojshme që pajisjet elektrike të përmbushin kërkesat përkatëse të sigurisë elektrike dhe përputhshmërisë elektromagnetike.

Për këtë arsye, kërkohet paraqitja e Deklaratës së Konformitetit CE/UE për elektropompat, me referim ndaj Direktivës 2014/35/EU për sigurinë e pajisjeve elektrike dhe Direktivës 2014/30/EU për përputhshmërinë elektromagnetike, ose akteve/standardeve ekuivalente të pranueshme. Direktivat përkatëse parashikojnë Deklaratën UE të Konformitetit si dokument përmes të cilit prodhuesi deklaron përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit me kërkesat përkatëse.

Kërkesa synon të mundësojë verifikimin paraprak të konformitetit të produkteve konkrete që do të furnizohen, duke garantuar që elektropompat dhe komponentët e tyre elektrikë janë të përshtatshëm për instalimin, integrimin dhe funksionimin në kushtet e përcaktuara në specifikimet teknike të stacionit të pompimit Fushë-Milot.

Për rrjedhojë, kriteri është **i lidhur drejtpërdrejt me objektin e kontratës, me mallrat konkrete objekt furnizimi dhe me kërkesat teknike të përcaktuara nga Autoriteti Kontraktor**, dhe është vendosur për garantimin e sigurisë, besueshmërisë, përputhshmërisë dhe funksionimit të duhur të elektropompave gjatë instalimit, testimit, komisionimit dhe operimit.

2.3.10 Operatori ekonomik duhet të paraqesë në sistemin elektronik deklaratën e konformitetit CE për inverterat e cila vërteton përputhshmërinë e tyre me direktivat europiane si më poshtë:

- 2014/35/EU Direktiva e tensionit të ulët
- 2014/30 EU Direktiva e përputhshmërisë elektromagnetike
- 2011/65/EU Direktiva e substancave të rrezikshme

Dhe standardet

- SSH EN 61800-5-1:2007+A1:2017 ose ekuivalent
- SSH EN IEC 61800-3:2018 ose ekuivalent

Argumentimi: Kërkesa që operatori ekonomik të paraqesë Deklaratën BE të Konformitetit për inverterin/VSD-në është përcaktuar në funksion të natyrës, fuqisë dhe kompleksitetit teknik të pajisjes që do të furnizohet, instalohet dhe konfigurohet në kuadër të kontratës.

1. Direktiva 2014/35/EU – Tensioni i ulët

Kërkesa për përputhshmërinë me Direktivën **2014/35/EU** lidhet me sigurinë elektrike të pajisjeve të furnizuara.

Direktiva ka për qëllim sigurimin e një niveli të lartë mbrojtjeje për shëndetin dhe sigurinë e personave dhe pronës gjatë përdorimit të pajisjeve elektrike që bien në fushën e saj të zbatimit.

Në rastin konkret, inverterat do të përdoren për komandimin e motorëve 355 kW dhe do të instalohen në sistemin elektrik të stacionit të pompimit. Për këtë arsye, verifikimi i përputhshmërisë së tyre me kërkesat e sigurisë elektrike është i domosdoshëm përpara furnizimit dhe instalimit.

Deklarata e Konformitetit UE/CE është dokumenti përmes të cilit prodhuesi deklaron përgjegjësinë për përputhshmërinë e pajisjes me kërkesat përkatëse.

2. Direktiva 2014/30/EU – Përputhshmëria elektromagnetike

Kërkesa për përputhshmërinë me Direktivën **2014/30/EU** lidhet drejtpërdrejt me natyrën e inverterave/VSD-ve, të cilët janë pajisje elektronike të fuqisë që realizojnë konvertimin dhe kontrollin e energjisë elektrike për komandimin e motorëve.

Në specifikimet teknike është kërkuar që inverterat të kenë, ndër të tjera, **filtra RFI të kategorisë C2**, çka lidhet me kontrollin e emetimeve elektromagnetike dhe përshtatshmërinë e pajisjes për përdorim në mjedisin industrial të parashikuar.

Përputhshmëria elektromagnetike është veçanërisht e rëndësishme në këtë projekt për shkak se inverterat do të funksionojnë së bashku me pajisje të tjera të sistemit elektrik, të kontrollit dhe komunikimit, përfshirë **HMI, PLC, SCADA dhe rrjetet industriale të komunikimit**.

Direktiva 2014/30/EU përcakton kërkesat për përputhshmërinë elektromagnetike dhe parashikon deklaratën e konformitetit të BE-së si pjesë të procedurës së vlerësimit të konformitetit.

3. Direktiva 2011/65/EU – Kufizimi i substancave të rrezikshme

Kërkesa për përputhshmërinë me Direktivën **2011/65/EU (RoHS)** lidhet me kontrollin e përdorimit të substancave të caktuara të rrezikshme në pajisjet elektrike dhe elektronike.

Duke qenë se inverterat/VSD-të janë pajisje elektrike dhe elektronike që do të furnizohen dhe instalohen si pjesë e sistemit të ri të stacionit të pompimit, kërkesa synon që pajisjet e ofruara të jenë në përputhje me kërkesat mjedisore dhe të sigurisë së përcaktuara nga legjislacioni përkatës.

Direktiva 2011/65/EU parashikon gjithashtu deklaratën e konformitetit të BE-së, përmes së cilës prodhuesi merr përgjegjësinë për përputhshmërinë e produktit me kërkesat e saj.

4. SSH EN 61800-5-1:2007+A1:2017 ose ekuivalent

Kërkesa për këtë standard lidhet drejtpërdrejt me faktin që pajisjet objekt furnizimi janë **sisteme elektrike të drejtimit të fuqisë me shpejtësi të ndryshueshme (Adjustable Speed Electrical Power Drive Systems)**.

Në projekt, inverterat/VSD-të do të përdoren pikërisht për kontrollin e motorëve elektrikë 355 kW dhe rregullimin e shpejtësisë së elektropompave.

Për rrjedhojë, kërkesa për përputhshmëri me standardin përkatës të sigurisë së sistemeve elektrike të drejtimit është e lidhur drejtpërdrejt me funksionin dhe përdorimin e inverterave në objektin e kontratës.

5. SSH EN IEC 61800-3:2018 ose ekuivalent

Kërkesa për këtë standard lidhet me **përputhshmërinë elektromagnetike të sistemeve të drejtimit elektrik me shpejtësi të ndryshueshme**, pra drejtpërdrejt me llojin e pajisjes që do të furnizohet.

Kjo është veçanërisht e rëndësishme në këtë projekt, pasi 8 inverterat do të instalohen në të njëjtin sistem elektrik dhe do të komunikojnë me sistemin e kontrollit nëpërmjet ndërfaqeve dhe protokolleve industriale të përcaktuara në specifikimet teknike.

Kërkesa synon të minimizojë rrezikun e ndërhyrjeve elektromagnetike që mund të ndikojnë në funksionimin e inverterave, motorëve, pajisjeve të kontrollit dhe komunikimit.

